



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 05, datë 28.02.2022

**Për miratimin e kontratës për riblerjen e titujve ndërmjet
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “t”, të nenit 53, pika 6, shkronja “b”, të nenit 59, pika 5 dhe pika 6 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 73, pika 4 dhe pika 5 të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 18, pika 2 të rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë kontratën për riblerjen e titujve ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për nënshkrimin e kësaj kontrate.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar